

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

**01.04.2021
Ora 11: 45**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, Znj.M.Koja, Z.N.Mezani

• **Parti Politike:**

PD, LSI, PS, LN, PDIU, PSD,

ADR, Nisma Thurje, BD

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë paraprkisht ndjesë për vonesën, por për shkak të nevojës për të patur të printuar hard copy, pra modelet e fletëve të votimit të cilat do të shqyrtohen në seancën e sotme publike, u detyruam ta fillojmë me vonesë këtë seancë. Sikurse e kemi njoftuar publikisht në rendin e ditës, mbledhja e sotme e Komisionerit Shtetëror është projektvendimi që ka të bëjë me miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për 12 njësitë zgjedhore, respektivisht për 12 qarqe. Tashmë që Komisioni Rregullator, vendosi që ta nxjerrë jashtë kompetencës së vet, çështjen e miratimit të përmbajtjes së fletëve të votimit duke nënkuptuar që kjo përgjegjësi dhe kompetencë është e Komisionerit Shtetëror. E kemi thirrur këtë mbledhje, pikërisht për të miratuar projektvendimin që ka të bëjë me përmbajtjen e fletës së votimit për të 12 njësitë zgjedhore. Atëherë përfaqësuesit e partive politike, janë njohur me propozimin, me përmbajtjen e

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

projektaktit, paraprakisht do të doja të risillja në vëmendje që, vendimi për miratimin e fletës së votimit është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor neni 98 pika 4, neni 117 pika 2 dhe neni 106 pika 1. Pas vlerësimit të disa varianteve në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit, kemi konsideruar si më të përshtatshme jo vetëm në përputhje me ligjin por edhe në kuptim të atyre kërkesave specifike të ligjit që kanë të bëjnë me kuptueshmërinë, lehtësinë e votuesit për të ushtruar të drejtën e tij të votimit, qartësinë e votimit. Kemi vlerësuar që, fleta e votimit e cila do të përmbajë emrat e kandidatëve, është më në përputhje me kërkesat e ligjit. Po më thuaj? Po jemi në shqyrtimin e kësaj, nuk e kemi vendosur, po diskutojmë, për këtë çështje.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Sepse e gjej me vend sepse mbrëmë jo vetëm që është shkelur ligji me mbledhjen, por edhe përtej unë kam përpara një urdher të Ministrisë së Shëndetësisë për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit që është për të gjithë shtetasit, që thotë; Lëvizja e shtetasve është nga ora, ndalohe nga ora 20 deri në orën 06 e mëngjesit dhe shtetasit lejohen të qarkullojnë përtej kësaj ore ose për nevoja shëndetësore, emergjence, ose pune, leja e punës për këtë merret ke e-Albania dhe mbledhja e Komisionit Rregullator dje, mbrëmë, është njoftuar për në orën 21:00, me një e-mail të ardhur në orën 20:45. Pavarësisht interesimit tonë gjatë gjithë ditës nëse do të kishte mbledhje ose jo, unë gjykoj që kjo mbledhje e mbajtur në këto kushte përveçse është e paligjshme, e pavlefshme etj, diskutim tjetër mendoj që ne si përfaqësues të subjekteve zgjedhore duhet të njihemi me vendimin e Komisionit Rregullator sepse informimi ynë ishte vetëm nëpërmjet medias dhe duke kuptuar arsyetimin e vendimit të Komisionit Rregullator mbi moskompetencën e shpallur mund të kemi dhe një analizë më të

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

hollësisht mbi diskrecionin tuaj si Komisioner për të miratuar fletën e votimit. Kështu që unë kërkoj që të njihemi me arsyetimin e vendimit të Komisionit Rregullator, të mbrëmshëm sepse si përfaqësuese e subjektit zgjedhor e kam patur të pamundur që për 15 minuta të marr lejen tek e-Albania dhe të vij në mbledhjen e Komisionit për të shtruar pretendimet tona apo kundërshtimet, çfarë mund të kemi patur për këtë vendim. Me këtë rast, gjej dhe rastin t'ju kërkoj që për herë të tjera, mbledhjet të kenë një, sigurisht që janë emergjente në këtë periudhë por të ketë një afat të arsyeshëm dhe të zbatohet i gjithë kuadri normativ edhe gjatë periudhës së pandemisë duke marrë parasysh edhe kufizimet në lëvizje. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po faleminderit zonja Bushati. Do ja përcjellim Komisionit Rregullator këtë shqetësim, por sikurse ju shumë mirë e dini, Komisioni Rregullator është një strukturë që është tërësisht e pavarur, është ad hoc, nuk varet nga Komisioneri Shtetëror dhe në këtë kontekst, mbledhja që po zhvillon sot Komisioneri, nuk imponohet nga sjellja e mëtejshme e Komisionit Rregullator apo edhe nga qëndrime që përfaqësues të ndryshëm të subjekteve, mund të mbajnë ndaj vendimarrjes Komisionit Rregullator. Mendoj që është në të drejtën tuaj për të disponuar në lidhje me aktin e djeshëm të Komisionit Rregullator. Komisioneri ka vlerësuar që të shqyrtojë projektaktin që ka të bëjë me përmbajtjen e fletës së votimit, natyrshëm edhe ndaj këtij vendimi të Komisionerit, secili prej subjekteve zgjedhore mundet të ketë qasjen që ai vlerëson se është më e përshtatshme në raport me ligjin. Atëherë duke u kthyer tek pika e rendit të ditës, po?

Z. I. Saliانji, përfaqësues i PS-së: Në fakt këtu jemi në shqyrtim të procesit administrativ, është në diskrecionin tuaj për të marrë vendimarrjen po përse i

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

përket shqyrtimit unë kërkoj që ju të bëni një shqyrtim më transparent duke, të shqyrtojmë të tre modelet e fletës së votimit, pavarësisht se nëqoftëse ju lexoni, ju po lexoni vendimin, pastaj i bie që ne mos diskutojmë, diskrecioni është i juaji, vendimarrja është e juaja por procesi administrativ jemi edhe ne. Tani në procesin administrativ unë mendoj që, se ne prandaj jemi këtu, kemi edhe ditë që diskutojmë dhe debatojmë si brenda kësaj salle dhe jashtë kësaj salle. Në procesin administrativ ne duhet t'i diskutojmë të tre variantet. Unë për modalitet të mbledhjes që ne duhet ta fillojmë për procedurë mbledhjen për shqyrtimin e të tre varianteve që ju na keni paraqitur si administratë pastaj ju si Komisioner keni qëndrimin tuaj dhe ne do diskutojmë në lidhje me procesin edhe në lidhje me qëndrimin tuaj, por duhet të fillojë procesi jo nga vendimi por shqyrtimi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po padiskutim dhe mendoj që është e natyrshme që kështu do të procedojmë. Kam përshtypjen që shqetësimi ishte i pa vend sepse jemi në fazën e diskutimit të projektaktit. Fakti që seanca është publike, presupozon që të dëgjojmë dhe mendimet dhe opinionet e përfaqësuesve të partive politike. Komisioneri akoma nuk e ka marrë vendimin në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit. Ne kemi bërë dhe kemi prezantuar një model, por gjithkush prej jush është i lirë për të diskutuar mbi atë model apo mbi 2 apo 3 modelet dhe versionet e tjera. Ne jemi këtu për të dëgjuar mendimet dhe opinionet e gjithë secilit prej jush dhe në fund do të vendosim. Kështu që, është e qartë mendoj që e drejta juaj për të dhënë mendime në lidhje me atë sesi do të jetë përmbajtja e fletës së votimit nuk është e mohuar në procedurën që po ndjekim dhe isha duke thënë që ajo çfarë Komisioneri ka propozuar, shkon në përputhje me parashikimet e nenit 98 pika 4, të Kodit

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Zgjedhor, të cilën më lejoni që ta citoj kjo dhe për transparencë të çdokujt tjetër të interesuar por më shumë të zgjedhësve; Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin thotë pika 4 e nenit 98, e Kodit Zgjedhor, thotë duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit, të mos jetë tejet e ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer. Nga leximi i kësaj dispozite në vlerësimin tim, është e qartë që në përmbajtjen e fletës së votimit, informacioni duhet të jetë si për subjektin zgjedhor po ashtu edhe për kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor që zgjedhësi do të votojë sipas rastit. Pyetja është nëse kandidati në fletën e votimit i shënuar me emër dhe mbiemër apo i shënuar në rastin tjetër me numër, në të dyja rastet e përmbush këtë përcaktim të Kodit Zgjedhor apo jo. Unë them që respektimi më i përputhur ose respektimi i plotë i Kodit Zgjedhor në lidhje me këtë moment, na bën që të kemi si zgjedhje të parë si zgjedhjen më të mirë atë sipas të cilës përmbajtja e fletës së votimit duhet të ketë të shënuar emër dhe mbiemër të kandidatit dhe kjo përforcohet dhe më shumë nga 106 pika 1, të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, në të cilën përcaktohet procedura e votimit. Pasi zgjedhësi merr fletën e votimit, ai hyn në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit, për subjektin zgjedhor dhe ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor, shenjën x ose plus ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij, pra fakti që në këtë pikë tregohet sesi do të jetë mënyra e votimit të zgjedhësit, duke shënuar subjektin zgjedhor dhe ose kandidatin e parapëlqyer do të thotë që do të duhet të kemi edhe

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

kandidatin të pasqyruar në fletën e votimit dhe më shumë akoma konfirmohet ose ky argument merr më shumë eko nëse shkojmë tek neni 117 pika 2, në të cilin përcaktohen llojet e votimeve dhe kriteret për vlerësimin e tyre, në pikën 2 thuhet; Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Pra do të thotë që në fletën e votimit do duhet të jenë të pasqyruar edhe kandidatët veç subjektit zgjedhor. Pikërisht bazuar mbi këto interpretime të këtyre 3 dispozitave të Kodit Zgjedhor, kemi vlerësuar që paraqitja në fletën e votimit edhe të emrave të kandidatëve shkon më për shtat me urdhërimet e Kodit Zgjedhor si dhe me interesin e votuesit për të patur një fletë votimi të qartë. Natyrshëm mund të them që në rastin e Tiranës, në të cilën numri i kandidatëve është relativisht i madh, mundet të ketë shqetësime në lidhje me identifikimin e kandidatëve, por në vlerësimin tim ky problem ngelet edhe në rastin kur fleta e votimit është me numra veçanërisht në kuptim të kohës që do ti duhet një zgjedhësi për të identifikuar kandidatin. Nëse fleta e votimit do të jetë vetëm me numra, pra kandidatët do të identifikohen vetëm me numra atëherë, zgjedhësi edhe në rastin më të mirë nëse do ta ketë të qartë numrin e kandidatit të cilin ai dëshiron të zgjedhi, do të duhet që në dhomën e fshehtësisë, në të cilën nëse do të jetë rasti që ne do të zgjedhim fletën e votimit, ku kandidatët janë shënuar me numra, do të duhet që të konsultojë numrin që do të jetë i shënuar në fletën e votimit me, do ti duhet që ta konsultojë numrin të cilin ai paraprakisht e ka identifikuar si kandidatin e tij të parapëlqyer, me fletën që ne do të vendosim aty në dhomën e fshehtësisë apo ndoshta dhe një mënyrë tjetër të paraqitjes së informacionit, sepse nëse do të mungojë kjo, një zgjedhës do të hyjë në dhomën e fshehtësisë me numrin në mendje të kandidatit parapëlqyes, për një arsye apo një tjetër mundet të mos ketë

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

siguri në nëse ai numër që ai do të shënojë do të jetë numër që ai parapëlqen do ti duhet që të bëjë një konsultë tjetër ose duke dalë jashtë dhomës së fshehtësisë ose duke pyetur nëse vërtet numri 6 apo numri 7 i kandidatit në një subjekt të caktuar është zgjedhja e tij parapëlqyese. Meraku të cilën ne kemi, që e kemi diskutuar në mënyrë të vazhdueshme me njëri-tjetrin mbi kohën që mund të marri procesi i përzgjedhjes nga një votues, unë mendoj që në rastin e fletës së votimit me numër kjo kohë është edhe më e madhe, në rastin kur është me emër ndoshta mund të ketë pak vështirësi për rastin e Tiranës, por do ta ketë të gjithë informacionin në fletën e votimit dhe ai mund ta identifikojë qartësisht në atë moment, emrin dhe numrin e kandidatit të cilin ai do të parapëlqejë. Gjithsesi, secili prej përfaqësuesve të partive politike ka rastin të japi mendimin e vet në lidhje me këtë çështje dhe argumentat e veta, kështu që fjala është për ju!

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Po mundem? Së pari, përpara se të filojmë konsultimin tonë në lidhje me projektaktin, unë doja t'ju bëja dy pyetje, cilat janë variantet që ju keni paraqitur si Komisioner, për fletën e votimit, pra sa është numri i tyre, së pari, në gjithë procesin e shqyrtimit në fletën e votimit, sa është numri i varianteve dhe lloji?

Z. I. Celibashi: Atëherë sikurse dhe ju po edhe të gjithë publikisht jemi njohur, diskutimi ka qenë në thelb ndërmjet 2 varianteve, me numra dhe me emra. Ka qenë varianti me numra sipas modelit të cilin juve jeni njohur dhe e kemi treguar edhe këtu dhe variantin me emra. Tek varianti me emra, janë 2 mundësi, mundësia i shënimit të emrave në formatin portret të fletës së votimit dhe mundësia e shënimit

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021**

të emrave në variantin horizontal. Këto treja variante kemi diskutuar, ose kanë qenë në diskutim,

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Ishte pyetja pra, të treja variantet të propozuara nga ana juaj?

Z. I. Celibashi: Jo nuk janë tre variante të propozuar, janë tre variante mbi të cilat kemi diskutuar.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Unë di që në e-mail, kam 3 variantet nga ju si Komisioner dhe nga administrata të paraqitur.

Z. I. Celibashi: Në thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit Rregullator kemi propozuar 3 variante dhe kemi diskutuar 3 variante.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Po,

Z. I. Celibashi: Pas rekomandimit të Komisionit Rregullator, për të patur një propozim konkret. Propozimi konkret ka konsistuar pastaj në paraqitjen e variantit me emra, por diskutimi është bërë mbi 3 variante dhe kemi menduar që ky është varianti, varianti me emra, varianti më i përshtatshëm.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Të paraqitura nga ju se kjo është shumë, se duhet të shënohet në procesverbal kjo për efekt procesi, të treja variantet se ne nuk kemi paraqitur asnjë variant.

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Z. I. Celibashi: Po Komisioneri ka të drejtën për të paraqitur projektaktet për shqyrtim në Komisionin Rregullator.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Jo e kemi dhe në e-mail domethënë variantet, po thjesht për procesin,

Z. I. Celibashi: E sqarova dhe njëherë, Komisionit Rregullator në mbledhjen e parë të thirrur prej tyre, ka qenë propozuar projektvendimi sipas të cilëve ishin 3 mundësi për ti lënë Komisionit Rregullator të drejtën e zgjedhjes. Komisioni Rregullator vlerësoi tha dhe bazuar dhe në propozimet e partive politike që të jetë një akt konkret sipas propozimit të Komisionerit dhe Komisioneri propozoi pastaj variantin me emra.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Ju si Komisioner keni paraqitur 3 variante dhe në momentin që keni paraqitur 3 variantet besoj të 3 variantet kanë qenë të konsultuara me ligjin. Nxjerrja e konkluzionit që, me një variant ju e keni bërë se varianti me numra dhe varianti tjetër është në kundërshtim me ligjin apo e keni gjetur më të përshtatshëm variantin që keni paraqitur sot?

Z. I. Celibashi: Unë më duket sesa e sqarova që, versioni i fletës së votimit në të cilën kandidatët janë të shënuar me emra shkon më në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, në lidhje me qartësinë e informacionit që duhet të përmbajë fleta e votimit. Kemi vlerësuar që shënimi i emrave në fletat e votimit, është më

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

ndihmuese për zgjedhësit dhe shkon në interesin e zgjedhësit për të marrë informacion dhe për të mos qenë konfuz ditën e votimit.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: E kuptoj pra, 2 variantet që nuk paraqiten për t'u shqyrtuar nga ana juaj në këtë mbledhje janë variantet të cilat kanë qenë në kundërshtim me ligjin apo janë variante, që ju duk ky më i qarti.

Z. I. Celibashi: Të tre variantet ndoshta edhe një variant i katërt ndoshta edhe një variant i katërmbëdhjetë, që do të propozonte Komisioneri, padiskutim që do të ishte në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe nuk po diskutojmë faktin që është apo nuk është në kundërshtim me ligjin. Ne vlerësojmë që varianti i propozuar shkon në përputhje të plotë me parashikimet e Kodit Zgjedhor, pasi Kodi Zgjedhor imponon që zgjedhja në lidhje me materialet e fletës së votimit duhet të jetë e tillë që ti krijojë lehtësi votuesit dhe vlerësojmë që lehtësi votuesit dhe kohë më shumë i kursethet votuesit, nëse fleta e votimit përmban të shënuar emrat dhe jo numrat. Nuk dua ti kthehem përsëri të njëjtit argument, të paktën në lidhje me kohën, nëse fleta e votimit do të përmbajë vetëm numrat.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Tani mund të vazhdoj me arsyetimin.

Z. I. Celibashi: Mundet, edhe po keni pyetje të tjera do të vazhdoj të përgjigjem.

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Tani përsa i përket, prandaj do filloj arsyetimin nga përgjigja e pyetjes tuaj, që të treja variantet janë variante që nuk bien në kundërshtim me ligjin, që do të thotë të tre variantet janë të mundshme për tu

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

zgjedhur nga Komisioneri, pavarësisht se ju keni zgjedhur një variant me arsytet që ju thatë. Përsa i përket mënyrës dhe përmbajtjes së fletës së votimit, thelbësore për ne është që në fletët e votimit të votohet qartë dhe thjeshtë, së pari dhe një proces shumë i rëndësishëm është dhe numërimi, ku do të numërohet shpejt dhe drejtë. Që të arrihet në këtë konkluzion së pari do, kjo ka të bëjë me hartimin e fletës. Që të votosh qartë dhe thjeshtë duhet që mënyra e votimit thotë neni 98 pika 4, fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin, duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor, mënyra e votimit parapëlqyese përcaktohet nga KQZ-ja, pra nga ju në këtë rast, në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë i ngarkuar. Konfigurimi i fletës të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe zgjedhësi të këtë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe kandidatëve e parapëlqyer. Në përmbajtjen e fletës së votimit në nenin 98 pika 3, ligjvënësi ka patur një qëllim të qartë ku e ka lidhur me emrin, thotë që në fletën e votimit duhet të jetë emri i subjektit zgjedhor i cili kandidon si dhe emri i kryetarit të partisë dhe këto të dy janë të padiskutueshëm, të pa negociueshëm, pra nëqoftëse fleta do ketë emra do të jenë vetëm këto emra.. Emri i subjektit dhe emri i kryetarit të partisë dhe i lë në diskrecion KQZ-së, për kandidatët ku, kur të bëhet fleta e votimit ti krijojë hapësirë që të votohet për kandidatët. Mendimi jonë është që kjo realizohet nga mënyra, nga numri i partive të regjistruar dhe nga fleta që ne kemi këtu, e vetmja mënyrë për të realizuar një votim, që të respektohet votimi në rradhë të parë për subjektet dhe për kandidatët parapëlqyes, është votimi me numra. Këtë ne nuk themi se e themi për tifoza, kjo nuk është tek, ne nuk e quajmë as tek, por ne këtë e themi se votimi siç e thashë dhe në fillim, të jetë një votim i një procesi të thjeshtë dhe të jetë sa më

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

i qartë. Fleta e votimit që unë këtu kam për Tiranën, ju e keni parë edhe ne e kemi ri parë, e bën jo të thjeshtë, për arsye se kemi një fletë e cila përmban 12 herë 36 kandidatë, pra përmban një fletë me 500 shënime, që janë vetëm emrat e kandidatëve duke qenë dhe kandidat i pavarur. Do thoja që kjo e ndërlikon fletën përsa i përket procesit të votimit, kurse procesi i fletës me numra që ju keni, ju lutem mund t'a nxirrni dhe në ekran, fleta është shumë e thjeshtë, votohet subjekti zgjedhor edhe numri për kandidatët. Tani përsa i përket kandidatëve nga të gjitha partitë politike, fushata bëhet me numra, pra të gjithë kandidatët po ti shikojmë fushata ka filluar, të gjithë thojnë, voto numrin e subjektit voto numrin e kandidatit. Vetë partitë, duke qenë emra të dëgjua partite, se dihet partia dhe përsa i përket në shënimin e partisë prapë të shënojnë numrin pra duke qenë një emër, Partia Demokratike, Partia Socialiste që janë emra që nuk harrohen, prapë reklama bëhet voto 12, voto 9, voto 6, voto 3, voto 5, etj etj. Pse ndodh kjo, se numri është ai që e bën votimin e thjeshtë dhe orientimin e zgjedhësit direkt nga fleta e votimit te numri, si përsa i përket subjektit dhe përsa i përket kandidatit. Unë besoj që ky proces është i lidhur shumë edhe me procesin e votimit. Unë nuk e di sesi mundet në numërim, kur të numërohet fleta në rradhë të parë vetë numëruesit e kanë shumë të vështirë për të përcaktuar kohën, pra atë që themi ne sot, duhet rezultati i shpejtë dhe kjo është nëqoftëse në këto zgjedhje së pari, pavarësisht rezultatit për ne është i rëndësishëm procesi. Do të thotë procesi dhe më i rëndësishëm që ndikon në procesin është shpejtësia e daljes së rezultatit. Një rezultat i dalë shpejt sjell një proces të drejtë, të pa kontestueshëm. Nëqoftëse ne do ecim me numërimin e kësaj flete gjatë numërimit, së pari vetë numëruesit që janë në tavolinë e kanë të pamundur që ta numërojnë. Ju lutem hapeni se e keni, i nderuar Komisioner, në kompjuter fletën e votimit me emra. Ajo është fleta që do

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021***

të duket në numërim, janë 12 subjekte zgjedhore të cilat, janë 10 subjekte zgjedhore të cilat nuk kanë numërues, por kanë vëzhgues dhe e kanë të pamundur që nga monitori siç nuk e shikojmë ne këtu se kjo është dhe largësia që do të jetë në numërim që ata të identifikojnë votën, pra me këtë vendimarrje që bëni ju sot, i mohoni të drejtën 12 vëzhguesve të partive, të gjithë partive tek e fundit edhe ne edhe pse kemi numërues por kemi edhe vëzhguesit, që vëzhguesit të jenë pjesë e procesit. Me këtë vendimarrje vëzhguesit dalin jashtë procesit, për arsye se secila prej këtyre fletëve ata nuk arrijnë të dallojnë se për kë është votuar dhe kjo është ajo që ne kërkojmë, pra nëqoftëse ju me fletën e votimit do mundësoni që votimi siç e thatë ju dhe numërimi që me këtë është një çënim shumë e rëndësishme e së drejtës për parti të cilat nuk kanë vëzhgues, i heq pothuajse të drejtën që ata t'i numërojnë votat e tyre si dhe transparencës së procesit. Unë do të thoja ta shikonit vendimarrjen tuaj dhe ta shikoni në prizmin thashë që në fillim, jo për tifozllik nuk është punë emrash dhe numrash, puna është e procesit!

***Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Z. I. Salianji, përfaqësues i PS-së: Në vonesën e ditës së votimit jemi në një situatë Covid-i, ku radhët në votime do jenë të papëlqyera nga të gjitha palët, dhe në qoftë se do votohet në Tiranë me këtë fletë, ne mendojmë që vonohet procesi i votimit. Vonesa në procese votimi sjell vonesë, si dhe radhë. Radha sjell ose shmangie nga votimi, ose do rrezikojmë jetën e njerëzve duke mbajtur radhë nëpër shkolla. Kurse, në qoftë se fleta e votimit do të ishte shumë e thjeshtë, kjo do të bënte që procesi i votimit të ecte në mënyrë të shpejtë. Kaq kisha për momentin. Për sa i përket pjesës së, vërtet e cituat në nenin 106 dhe 119, por 106 dhe 119, ju detyron që, ju thotë që, vërtet e keni për në varësi të pjesëmarrësve në subjekt. Në qoftë se do ishim me dy subjekte, kjo ishte e mundshme për t'u bërë, dhe në varësi të kandidatëve, se në qoftë se ligjvënësi do kishte pasur qëllimin për ta bërë me emra në 98, pika 4, do të thoshte emrat e kandidatëve, siç ka thënë emrat e kryetarëve të partive. Pra, nuk është se i ka shpëtuar, se me emrin është marrë, është marrë një paragraf më sipër, por ta ka lënë në varësi të numrit të kandidatëve. Kaq kisha dhe rezervoj të drejtën pastaj të flas prapë.

Z.I. Celibashi: Faleminderit! Zonja Bushati pastaj zoti Kaso.

Z. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Atëherë, së pari, ju në fjalën tuaj thatë që, në fillim kisha 3 variante propozuar Komisionit Rregullator dhe Komisioni Rregullator rekomandoi që të dilja me një variant. Kjo si fjali nuk qëndron për shkak se, ose është në gabim më saktë, sepse Komisioni Rregullator shpalli moskompetencën dhe nuk ka asnjë parashikim ligjor në fjalinë që thoni ju, që Komisioni Rregullator rekomandoi që unë të dilja me një variant. Në këtë kuptim doja fillimisht, para se të bëja një argumentim doja të dija, të bëja një pyetje nëse është e mundur nga ju të përgjigjeni. Mbi ç'bazë ju pak a shumë vendosët që nga 3

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

variantet, pra përtej atij shpjegimi që thatë në raport me Kodin Zgjedhor, ky i propozuar nga ju sot, i propozuar vetes në fakt nga ju sot, është më i miri, duke pasur parasysh edhe ndonjë praktikë të ndonjë vendi tjetër. Pra, ka në konsultën që ju keni bërë gjatë, pra nga pardje në darkë deri sot në mëngjes, nëse ndonjë shtet tjetër që ka të njëjtin sistem zgjedhor, aplikon këtë lloj flete votimi, sepse të paktën edhe në informacionin e gjerë të publikut, shteti më i afërt që kemi ne në rajon dhe që jemi njohur për mënyrën e ngjashme, është Republika e Kosovës, ku është aplikuar një fletë tjetër votimi dhe madje, edhe për shkak të aplikimit me numra, ka pasur një numër shumë të madh përqindjesh, një përqindje të lartë të pavlefshmërisë së votave. Prandaj, doja të dija pra, së pari, për sa kohë që ju vetë pranuat që të 3 variantet, 3 ose 14, ju keni bindjen që ishin konform ligjit, përse, sepse fjalia që na rekomandoi Rregullatori nuk vlen, për shkak se Rregullatori tha vetë që s'ka kompetencë, u përfundua, u finalizua sot me një variant dhe nëse kjo është konsultuar me ndonjë shtet të BE-së, apo ndonjë rajon tjetër për këtë model flete votimi të relatuar nga ju, të sapo relatuar nga ju.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Konsultimet kanë qenë të gjithanshme me publikun, me partitë politike edhe me eksperiencat të vendeve të tjera. Thjesht për ilustrim po sjell rastin e Kroacisë, modeli i fletës së votimit që ne mendojmë që është i përshtatshëm, është një model flete votimi që është i përshtatshëm për t'u implementuar, për t'u përdorur këtu tek ne, është një model që është përdorur dhe në Kroaci, por tej kësaj ajo çfarë ngelet më e rëndësishme është fakti që, në vlerësimin tonë, që pa diskutim ka subjektivitetin e vet çdo lloj vlerësimi, i çdokujt. Fleta e votimit, në të cilën janë të shënuar emrat e kandidatëve e ndihmon zgjedhësin më shumë, sesa në rastin kur fleta e votimit nuk i ka të shënuar emrat e kandidatëve. Nëse e konsiderojmë si konsultim publik, mundet të sjellë në ilustrim

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

edhe konsultimin publik nëpërmjet rrjeteve sociale që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë, ku qartësisht në shumicë dërrmuese, të paktën ata që janë angazhuar në këtë sondazh kanë mbështetur variantin e fletës së votimit me emra kandidatësh të shënuar në fletën e votimit. Nuk mund ta them që kjo ka qenë përcaktuese, por gjithsesi edhe ky është një argument në këtë. Tani ne, këtë zgjedhje të arsyetuar sipas nesh kemi bërë, ju jeni të lirë që të jepni mendimet dhe opinionet tuaja në lidhje me atë se, cili do të ishte opsioni më i mirë edhe për juve si përfaqësues të partive politike, se në fund të fundit ju jeni në garë.

Z. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Unë nuk dua të kaloj edhe në përsëritje të asaj çfarë tha kolegu përfaqësues i subjektit tjetër zgjedhor, por natyrshëm që një sondazh në rrjetet sociale do nxjerrë fletë parapëlqyese variantin me emrat e kandidatëve, për faktin se dihet që përdorues të rrjeteve sociale janë mosha relativisht të reja ose deri të mesme, të informuara dhe që nuk e kanë problem dhe të identifikojnë kandidatë jo më parti në një fletë votimi, sado e madhe dhe sado me shumë subjekte të jetë ajo. Kështu që mendoj që argumentimi se nga sondazhi në rrjetet sociale, pjesa dërrmuese ka preferuar ato me emra, nuk mund të merret parasysh në vlerësim për faktin se numri i përdoruesve të rrjeteve sociale është i kufizuar dhe siç e thashë konsiderohet që janë përdorues të informuar. Ne si subjekt zgjedhor jemi për variantin më të thjeshtë të mundshëm dhe që garanton barazi jo vetëm mes subjekteve zgjedhore, por në fakt edhe midis vetë zgjedhësve në ushtrimin e tyre të votës. Në këtë kuptim, ne jemi në favor të fletës së votimit me numra, sipas variantit që është tani në ekran, sepse këtë e konsiderojmë më të thjeshtin, edhe sepse ju vetë e keni deklaruar në propozimin tuaj, që është dhe në përputhje me ligjin dhe ajo që kam si kundërshtim mbi pretendimin tuaj është se varianti me emra është më i miri, është për faktin se varianti që ju propozoni në

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

fakt shkakton një diferencë në lehtësinë sesi ushtrohet e drejta e votës. Nëse fleta e votimit është me të njëjtën përmasë për të gjitha qarqet, tjetër lehtësi ka në Qarkun e Kukësit për të evidentuar kandidatët dhe tjetër vështirësi ka në qarkun e Tiranës për të evidentuar kandidatët. Është shumë e thjeshtë të orientohesh në një fletë ku ka vetëm 6 kandidatë dhe është shumë e vështirë për shumëkënd në një qark si Tirana për të evidentuar midis 500 emrave kandidatët. Pra çfarë do ndodhë? Do ndodhë që në qarkun më të madh të Shqipërisë, që prodhon numrin më të madh të mandateve, rreziku është që për shkak të vështirësisë së zgjedhësve në identifikim, numri i votave të pavlefshme të jetë tejet i lartë. Kjo sjell jo vetëm problematikën që për arsye kohe nuk po përmendim këtu në këtë qark, por ju nuk i vendosni në një bazë të barabartë zgjedhësit në ushtrimin e së drejtës së tyre. Kjo kërkesë mendoj se realizohet më mirë me variantin ku të gjitha partitë janë të listuara njëra pas tjetrës, jo ca, as në linjën siç është, pra në variantin paralel apo në variantin me dy rreshta partish, po themi, por kjo barazi është më mirë e shprehur në një fletë votimi që është më lehtësisht e kuptueshme për zgjedhësit si në Kukës, si në Tiranë, si në Shkodër, kudo. Pretendimi se duhet të jetë dhe se s'bën emri i kandidatit, nuk ka asnjë, nuk reflektohet në asnjë kërkesë të Kodit Zgjedhor. Askund nuk është e shprehur që kandidati duhet të jetë me emër, aty thuhet të vendoset një shenjë "x" ose "minus", ose një shenjë tjetër e dallueshme dhe kjo nënkupton që përveç partisë që ka një numër sipas shortit, ka çdo kandidat siç e dimë, e kemi parë që ka dhe numrin e vet në renditjen e listës së subjektit të vet zgjedhor. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Zoti Kaso, pastaj përfaqësuesi i Partisë Drejtësi për Integrim, pastaj përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pastaj Nisma Thurje.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti kryetar! Ka një parim të madh për sa i përket çështjes së zgjedhjeve që shpesh kemi tendencën të harrojmë duke qenë që na merr dhe pak kjo pjesa e tifozalet politik, sepse si përfaqësues që jemi pavarësisht se besoj, jemi të gjithë juristë, jemi mbi të gjitha përfaqësues politikë dhe shpeshherë tendenca që interesi politik të prevalojë mbi interesa të tjera për sa i përket zgjedhjeve, është e natyrshme, por nuk duhet të na rrëmbejë dhe nuk duhet të jetë kjo tendencë që të jetë udhërrëfyese jonë në vendimmarrje, aq më tepër vendimmarrje delikate, siç është çështja e fletëve të votimit. Parimi është që zgjedhjet janë për zgjedhësit dhe pastaj për subjektet garuese. Çdo gjë do vënë në funksion të zgjedhësit, çdo gjë do parë nga këndvështrimi i zgjedhësit. Ju kujtoj këtu që në zgjedhjet e fundit të organizuara, që në fakt nuk ishin zgjedhje, ishin votime, ishte vetë ODIHR-i që hap, çel raportin e vëzhgimit përfundimtar me këtë parim të rëndësishëm duke i risjellë në mendje, jo vetëm forcës së vetme politike garuese, por dhe administruesve të zgjedhjeve, që zgjedhjet ishin pa standarde për shkak se nuk ishin në funksion të interesit primar që duhet të garantojë interesin e zgjedhësit, kështu që ta kthejmë pak mendoj unë fokusin nga interesi i zgjedhësit. Cili është interesi i zgjedhësit? E thotë legjislatori në momentin kur definojnë dhe përcaktojnë në nenin 98, në mënyrë shteruese në këndvështrimin tim, përmbajtjen e fletës së votimit, dhe thotë që fleta e votimit duhet të jetë e qartë, e kuptueshme për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer. Pra, zgjedhësi në fletën e votimit duhet të gjejë subjektin zgjedhor, zgjedhësi në fletën e votimit duhet të gjejë kandidatin e parapëlqyer. Tani është afërmendsh, si identifikohet kandidati, me emër apo me numër? Janë njerëz, kanë të drejtën që ua garanton Kushtetuta dhe kanë shprehur vullnetin për të garuar. Njerëzit identifikohen me emra, nuk identifikohen njerëzit

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

me numra. Është çudi e madhe që subjektet politike që deri pak muaj më parë ishin dashnorë të mëdhenj të listave të hapura, sot tentojnë që të fshehin kandidatët pas numrave. Epo kjo gjë nuk mund të ndodhë! Nuk mund të fshihen kandidatët mbas numrave. Nuk mund të enkriptojmë fletën e votimit në mënyrë që administrata ta ketë më të lehtë punën nesër për të numëruar fletët e votimit, që dhe për këtë, që nuk jam i sigurtë, se nuk qëndron dhe ky si argument, por dhe sikur të qëndronte, nuk mund të prevalojë interesi i administratës për të mbaruar punën më shpejt në raport me interesin e zgjedhësve për të gjetur kandidatin parapëlqyes në fletën e votimit. I hapët listat? Ndërhytë në Kushtetutë, në mënyrë të njëanshme se ua desh qejfi dhe interesi elektorale? Ndërhytë në Kodin Zgjedhor në mënyrë të njëanshme se ua desh qejfi dhe interesi elektorale, me pretekstin e hapjes së listave? Lista të hapura ka, kur kandidatët identifikohen me emër, me mbiemër, mundësisht dhe me fotografi, pse jo, por ka zgjedhje të tjera për të eksperimentuar edhe risi të tjera që shkojnë më afër me vullnetin dhe interesin e zgjedhësve dhe nuk ka asnjë shans që fleta e votimit të mos ketë të lehtë identifikimin e kandidatit të parapëlqyer. E mori për analogji kolegu im i Partisë Socialiste kur e lexoi nenin 98, pika 4, thotë që, po të kishte dashur ligjvënësi, e thoshte atje, emrin e kandidatit, por do ta kishte patur shumë herë ligjvënësi më të thjeshtë në qoftë se do kishte dashur, kur thoshte, votimin e subjektit zgjedhor dhe numrit të kandidatit të parapëlqyer, se bënte përjashtime nga rregulli, dhe rregulli është që identifikohet me emër, me mbiemër, qartësisht. Qartësisht do të thotë, të dijë për kë voton. Të dijë për kë voton, do të thotë, që nuk voton për një numër, do të thotë që voton për një emër, do të thotë që voton për një kandidat. Dhe diferenca e këtyre botëkuptimeve është një vijë e fortë dhe e qartë ndarjeje midis zgjedhjeve me standarde, me këto standarde të deri një farë niveli, sigurisht nuk jemi të kënaqur me ndryshimet e Kodit, e kemi thënë dhe vazhdojmë ta themi, por jemi 25 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe me këtë Kod do

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

ecim, dhe me këto rregulla do ecim. Do kemi kohë më vonë ta diskutojmë, por këto standarde, të paktën këto standarde që vetë janë shkruar dhe janë imponuar si kanë dashur, duhet t'i zbatohet. Është një vijë, e ritheksoj edhe një herë, e qartë ndarjeje midis standardit të pranueshëm të zgjedhjeve dhe standardit jodemokratik dhe tërësisht të papranueshëm të zgjedhjeve. Dhe këtë e bën fleta e votimit si mekanizëm që duhet të garantojë shprehjen e një vullneti të qartë të zgjedhësve, kështu që kjo është një pikë, jo vetëm e patolerueshme nga ana jonë, se nuk kemi çfarë të tolerojmë, por është e pakonceptueshme sesi një subjekt që është betuar dhe stërbetuar për hapjen e listave, tani thotë t'i mbylлим, t'i fshehim edhe ta bëjmë bingo fletën e votimit. Kjo nuk qëndron dhe nuk mund të qëndrojë. Prandaj i nderuar, propozimi juaj që fleta e votimit duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e kandidatëve, të cilët janë regjistruar si të tillë, për ne është i pranueshëm, dhe sigurisht kemi shprehur dhe vazhdojmë të shprehim parapëlqimin tonë për një model flete votimi të paraqitur nga ana juaj, që është modeli që i përmban të radhitura në katër radhë subjektet nga tre, pra të orientuara portret, në tabelën tuaj, sigurisht është më i lehtë identifikimi i subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve me atë model dhe këtë e ka provuar fakti, siç u përmend më përpara që në vetë sondazhin e organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në faqen e vet zyrtare, ky model jo vetëm ka prevaluar por ka prevaluar në dijeninë time me një mazhorancë dërrmuese votash, në mos gaboj 79% të pëlqimeve në raport me modelet e tjera të cilat ishin hedhur. Pra, qartësisht shqiptarët në një masë të madhe kanë folur dhe e kanë shprehur jo vetëm parapëlqimin, por dhe lehtësinë e identifikimit të vullnetit të tyre me atë mekanizëm, pra me atë lloj flete votimi. Qartësisht jemi dhe i japim mbështetje atij propozimi të Komisionerit me një rezervë, kemi sjellë ditën e djeshme një shkresë zyrtare, kemi ngritur një shqetësim nga ato që përmban neni 66 i Kodit Zgjedhor, për sa i përket logos së subjektit

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Bindja Demokratike, që ka ngjashmëri me logon tonë dhe besoj që ky shqetësim është duke u marrë në konsideratë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për t'u zgjidhur, dhe çfarëdo lloj vendimmarrje Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në cilësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të jetë duke marrë, ose do të marrë menjëherë pas përfundimit të diskutimeve, duam që të, meqenëse modelet që kanë ardhur tani për diskutim në sallë, janë modele të vjetra përsa u përket logove, të miratohet me një rezervë përsa i përket kësaj pike. Kaq kisha për këtë temë të rendit të ditës. Në përfundim të kësaj pike të rendit të ditës do doja të kalonim në fund dhe të flisja për një shqetësim jashtë rendit të ditës. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëherë, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Faleminderit zoti Kryetar. Qëndrimi i mbajtur nga subjekti politik që përfaqësoj, vjen në nismën ligjore dhe në frymën e Kodit Zgjedhor të relatuar nga ana juaj. Shprehim dakordësinë tonë të plotë me versionin tuaj se është versioni që vetë ligjvënësi ka dashur të zgjedhë si version përfundimtar të konsoliduar me fletën e votimit. Ngremë dyshime për qëndrimet e mbajtura nga Partia Socialiste në këtë rast duke parë që vetë pjesa e nenit 98 është ndryshuar me ligjin 118 të vitit 2020. Një ligj i anshëm totalisht i pakonsultuar në këshillin politik, i cili në pikën 4 ka futur atë që është konfigurimi i fletës duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit parapëlqyes. Ne këtu flasim për subjekte, të cilat identifikohen ndërmjet emrin të tyre dhe jo ndërmjet numrit. Të gjitha procedurat pranë këtij institucioni, një subjekt i bën në emrin e vet. Në listat shumëmbrore është me emra dhe jo me numra. Po ashtu zoti Kryetar, ne jemi shumë dakord me fletën e votimit të shfaqur në anën tuaj të djathtë të ekranit, e cila është në përputhje të plotë me parashikimet e kodit. Për të bërë një lloj eksperimenti do ta pyesja si kolegen ashtu dhe kolegun, në qoftë se ata në listën e Tiranës do të dinë të na thonë numrin 29 të listës së tyre. Cili është numri 29 i Lëvizjes për Ndryshim, ose i Partisë Socialiste në listën e Tiranës, besoj se dhe ata vetë nuk e kanë këtë informacion. Nuk janë të gatshëm ose në gjendje që të na e thonë jo më një zgjedhës i thjeshtë që të identifikojë një votim parapëlqyes për një kandidat të caktuar ndërmjet një numri. Është shumë e qartë në fletën e votimit i nderuar zoti Kryetar, janë të dyja elementet që kërkohen nga subjektet politike. Është elementi i numrit dhe në krah të tij është elementi i emrit. Pra, janë të dy kushtet kumulative në qoftë se do t'i quajmë të tilla. Për sa i përket pjesës së referuar nga përfaqësuesi i subjektit politik Partia Socialiste, lidhur me një hap të mëvonshëm që është ai i numërimit, ky nuk është fare një shqetësim, numëruesit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021**

janë persona të zgjedhur nga subjekte politike. Numëruesit janë persona që paguhen për të ushtruar atë detyrë duhet ta ushtrojnë jo me shpejtësi, nuk ka asnjë lloj nxitimi vetëm me korrektësi dhe ligjshmëri. Ky duhet të jetë thelbi i procedurës së numërimit dhe jo shpejtësia sa më shpejt t'i numërojmë aq më mirë është, jo nuk është fare kjo. Kemi të gjithë kohën e kësaj bote, nuk qëndron asnjë nga argumentet e dhëna. Thjesht orientimi i përfaqësuesve të subjekteve që kërkojnë që në fletën e votimit të jenë vetëm numra, ka një qëllim deri diku diabolik të cilin keqorienton zgjedhësit dhe nuk identifikon vetë atë që është fryma e Kodit, për votat parapëlqyese për subjekte zgjedhor dhe për kandidatët e tyre, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i PDIU-së.

Z. Sh. Sula, përfaqësues i PDIU-së: Paraprakisht kërkova që të merrja fjalën që t'i kërkoja nga ana procedurale Komisionerit që të vendosim një rregull për sa i përket afatit kohor të të folurit të çdo personi apo përfaqësuesi të partisë politike, sepse po shohim që po na mbahen leksione. Kjo është një mbledhje e cila jemi mbledhur, jemi thirrur për mbledhje për të dhënë mendime në lidhje me projektaktin mbi fletën e votimit dhe nuk kemi ardhur për të bërë konsultime rreth fletës së votimit. Për mua do të ishte fare e thjeshtë zoti Kryetar, siç ka ndodhur një precedent dje që Komisioneri...

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Kryetar, për procedurë, një sekondë. Këtu po merremi me fletën, dje dëgjova nga ju si Kryetar që nuk janë subjekt zgjedhor, pra ju vetë si Kryetar për forcën politike që po flet thatë që nuk është subjekt zgjedhor. Tani po jep leksione këtu, po ha dhe kohën tuaj.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Z. Sh. Sula, përfaqësues i PDIU-së: Mundet të vazhdoj Komisioner? Nuk dua më ndërprerje se po dëgjojmë shumë historira këtu.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me fletën e votimit si përfaqësues i një partie politike mundet të ketë të drejtën për të folur për fletën e votimit. Rekomandimi juaj për t'i qëndruar përmbajtjes së diskutimit të çështjes, qëndron.

Z. Sh. Sula, përfaqësues i PDIU-së: Nuk dua më ndërprerje se po dëgjojmë shumë historira këtu. Atëherë dje isha në vazhdim të bisedës që nga Komisioneri në mënyrë të paprecedentë u muar një vendim në lidhje me numëruesin. Ne jemi regjistruar me vendim të Komisionerit si subjekt zgjedhor. Të gjithë e dinë ky vendim është në arkivën e sistemit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Prandaj është e thjeshtë mund të pyesni PS-në dhe PD-në si e duan ata fletën e votimit është e thjeshtë. Për respekt shumë shkurt, në lidhje me projektaktin e fletës së votimit. Është fare e qartë zoti Kryetar, neni 97, neni 98, pika 4, paragrafi i parë i nenit 97 fleta e votimit “për zgjedhjet votohet me një fletë me ngjyrë dhe me një formë të njëjtat për të gjitha zonat zgjedhore”. Çfarë ka që të mos jetë fleta e votimit me të gjitha numrat e partisë dhe me kandidatët me emra të tyre me emër dhe mbiemër. Sjell në kujtesë në komisionin politik të reformës zgjedhore vetë Kryeministri i nderuar, ka ardhur nga ora 9:00 deri në ora 16:00 dhe ka folur për listat e hapura. Ndërsa sot dëgjojmë nga përfaqësuesi i tij gjëra të tjera. Për mua është fare e thjeshtë, një fletë votimi e thjeshtë, e qartë për votuesin të shprehë vullnetin e tij të jetë i rentuar. Duke qenë plotësisht dakord me çfarë u propozua dhe çfarë u tha nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike por dhe nga përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim. Jemi dakord me fletën që është në krahun tuaj të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

djathtë zoti Kryetar, se siç duket ju keni një mandat 8-vjeçar dhe normalisht do të keni nevojë dhe për të djathtën, ju faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit, atëherë fjala për përfaqësuesin e Partisë Nisma Thurje.

Z. N. Laska, përfaqësues i Partisë Nisma Thurje: Së pari jemi shumë dakord me variantin e propozuar nga Komisioneri në këtë projektakt. Jo vetëm se i përmbahet të gjitha dispozitave të Kodit Zgjedhor, por edhe duke qenë se këto zgjedhje janë për zgjedhësit sigurisht dhe për subjektet politike, por së pari për zgjedhësit. Zgjedhësit e kanë shprehur vullnetin e tyre me anë të sondazhit që ju keni publikuar në faqen tuaj në Facebook. Së dyti, doja të thoja që këtu u ngritën pretendimet mbi qartësinë se ku është më e qartë fleta e votimit duke qenë me emra apo me numra. Unë nuk e kuptoj sesi mund të pretendohet që një fletë votimi është vetëm e qartë me numra dhe është më e paqartë kur ka dhe numrat dhe emrat. Aty për sa kohë ne votojmë për emrat dhe nuk po bëjmë telebingo dhe nuk po zgjedhim numrat. Së fundi, duke e parë nga pozicioni i një subjekti politik që sigurisht kemi vetëm vëzhgues dhe jo numërues në tavolinë. Unë isha duke parë ekranet ndërkohë që fletët e votimit, modelet e fletëve të votimit aty ndërroheshin dhe nga këto pozita unë shoh dhe gjykoj që e kam më të qartë fletën për të parë mënyrën sesi është zgjedhur fletën e votimit e cila është me emra, sesa fletën e votimit e cila është me numra. Supozojmë se diku aty nga mesi i asaj flete është vendosur një “X”, unë e kam praktikisht të pamundur se cili numër është aty. Nga ana tjetër në modelin tjetër të fletës së votimit është shumë më i thjeshtë orientimi se cilit emër i përket ajo votë. Kështu që në këtë këndvështrim ne jemi plotësisht dakord me propozimin tuaj për fletën e votimit me emra dhe me numra.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i Partisë Socialdemokrate.

Z. R. Preçi, përfaqësues i PSD-së: Faleminderit, zoti Kryetar. Ne si parti politike Partia Socialdemokrate, në këtë fushatë mendojmë se.. dëgjova të gjitha diskutimet e shokëve, kolegëve dhe ne si PSD po e bëjmë fushatën me emra. Secili kandidat prezantohet me emrin e vet dhe na duket, pa bërë shumë teori, që të jetë fleta sa më e qartë, gjithçka bëhet për zgjedhësit. Kështu që ne kemi mendimin që si subjekt politik, kjo fletë votimi me emra është më e mirë për votuesit, pavarësisht vështirësive që ka. Prandaj ne mendojmë që lista, fleta e votimit me subjekt parti politike që shoqëria jonë është e para si subjekt të jetë me listë emërore, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit, përfaqësuesi i Bindjes Demokratike?

Z. F. Topollari, përfaqësues i Partisë BD-së: Faleminderit, zoti Komisioner. Sigurisht që është e qartë që një fletë votimi me emra është më e qartë aq më tepër që Kushtetuta ka shtuar dhe votimin preferencial pra, që votuesit nuk do votojnë më vetëm për subjektin politik por edhe për kandidatin e tyre të preferuar. Sikurse për hir të së vërtetës, unë mendoj që është gjithashtu pak problematike një fletë votimi, vetëm në rastin e Tiranës ku janë afërsisht mbi 450 kandidatë dhe do duhet të shkruhen gjithë emrat e secilit. Gjithësesi nëse ne kemi vullnetin e mirë, unë mendoj që edhe kjo është një pikë që mund të tejkalohet. Sigurisht nuk mund të lë pa vënë në vëmendje që ne e kemi të vështirë të realizojmë të paktën për qytetin e Tiranës fletën e votimit me të gjithë emrat. Imagjinoni sa e vështirë do të kishte qenë që të pranohej edhe kërkesa e Partisë Demokratike, ku në çdo qark secili

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

subjekt zgjedhor do të kishte kandidatë aq sa të dëshironte ai. Do të bëhej fare e pamundur kjo gjë. Gjithësesi unë mendoj që nëse zgjedhim variantin e fletës së votimit me emra, por horizontal, ai mund të jetë i njëjti format me të njëjtat përmasa, të dhëna kryesore e dizajn që të përdoret në gjithë Shqipërinë me emrat e kandidatëve, ndërsa në Tiranë apo dhe qarqe të tjera ku mund të ketë një mbingarkesë, fleta e votimit për shkak të numrit shumë të madh të kandidatëve të bëhet me initiale. Iniciali i emrit është shkronja e parë e emrit, shkronja e parë e mbiemrit të secilit kandidat. Është praktikisht një e dhënë e emrit që do të thotë që votuesi e identifikon edhe nëpërmjet inicialit kandidatin e tij të preferuar dhe e ka po aq të lehtë, jo krejt njësoj dhe po të bëhet raporti me anulim që krijon të paktën në Qytetin e Tiranës vendosja e 500 emrave në fletën e votimin. Kjo mund të ishte një zgjidhje optimale nëse ju e gjykoni. Tani sa për shqetësimin e përfaqësuesit të Partisë Demokratike përsa i përket siglës në fletën e votimit të Partisë Bindja Demokratike dhe të Partisë Demokratike, ne kemi marrë një vendim dhe do ta sjellim punë minutash logon e stilizuar. Pavarësisht se ne kemi një “B” të stilizuar Partia Demokratike ka një “D” të stilizuar. Nuk është faji ynë që kemi një emër tjetër, elementë të tjerë, por logot e partive janë shkronja të stilizuara. S’kemi si t’ia bëjmë gjithësesi pavarësisht kësaj, ne e kemi ndryshuar, e kemi shtuar edhe emrin e partisë poshtë logos. Kjo maska përshembull do të jetë pothuajse identik me logon e re që ne do të kemi. Unë këtë maskën e kam përdorur në mbledhjen e KQZ-së dy javë përpara, edhe pa u shtruar ky debat, pavarësisht se është shumë e rëndë që debati shtrohet ditën e fundit. Nuk mund të shtrohet ditën e fundit sepse edhe ne duhet të kemi kohën tonë për të marrë vendime mbi çështjet tona. Kështu që unë e konsideroj të mbyllur edhe pjesën e stilizimit të logos. Në bazë të nenit 66, ne dhe Partia Demokratike jemi në kushte të barabarta për sa i përket asaj që duhet ta ndërrojë logon, gjithësesi ne me kënaqësi e kemi ndërruar logon në kohë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021**

rekord me qëllim që fleta e votimit të bëhet sa më shpejt dhe të vazhdojë procesi pasi jemi vonuar shumë për një element kaq teknik po dhe shumë të rëndësishëm siç është forma e fletës së votimit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. Përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokracia e Re.


Përfaqësues i Partisë ADR: Përshëndetje, sikurse e tha dhe kolegu që është në krahun tim të djathtë, lista nga vetë emri i vet kuptohet që është listë shumëmemërore dhe ne gjithashtu si ADR jemi për variantin e listës me emra. Kjo sipas gjykimit tonë është në transparencë të plotë dhe kryen funksionin sipas mendimit tonë të saktë. Varianti me numra ndoshta është praktik po mund të sjellë konfuzion dhe mund të ketë një problematikë në orientim dhe votim të njerëzve dhe tek dhënia e votës ku ata vërtet duan, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, kemi diskutime të tjera? Po, përfaqësuesi i Partisë Socialiste.

Z. E. Saliq, përfaqësues i PS: Po, faleminderit. I dëgjova të gjitha diskutimet dhe normalisht ne jemi koshient në atë çfarë kemi thënë dhe nuk e themi siç e thashë në fillim tifoçllik. Nuk kemi menduar që kjo mund të zgjidhet me Facebook, normalisht militantët e Partisë Socialiste janë me mijëra dhe mund të kishin klikuar te Facebooku juaj dhe sot do të ishte shumë ndryshe ai rezultat por nuk e kemi menduar që këtë lloj vendimmarrje kaq të rëndësishme mund t'i lihen tifoçllikut dhe ky të jetë një argument që “shih se ne e hodhëm në facebook këto”. Prandaj së pari kërkojmë zbatimin e ligjit dhe së dyti, një pjekuri në mënyrën e vendimmarrjes. Ne nuk kemi thënë që jemi kundër listës me emra. Ne kemi thënë

Zbardhi materialin audio


Merita DULAKU



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021**

nga mënyra sesi sot po figurohet gara në zgjedhje, nga numri i kandidatëve e bën të pamundur bërjen e fletës së votimit. Nëqoftëse nuk do të ishte kjo fleta e Tiranës pra, do të ishte e qartë dhe jo siç thotë ligji “tejet e ngarkuar”. Pra nuk do ishte tejet e ngarkuar. Ajo ç’ka thotë ligjvënësi, nëqoftëse do të kishte parasysh KQZ-ja, “që fleta të mos jetë tejet e ngarkuar”, kjo pikë këtu nuk zbatohet. Nëqoftëse nuk do ishte tejet e ngarkuar patjetër ne do të ishim me emra. Por midis rrëmujës dhe rregullit ne kemi zgjedhur rregullin. Cili e sjell rregullin në këtë rast? E sjell numri dhe prandaj kërkojmë që ju si Komisioner para se të merrni vendimin të rikonsideroni aktin tuaj. Nuk është se nuk e keni bërë, disa herë e keni bërë në këtë mbledhje, pranë këtij omisioni, por pavarësisht aktit ka ndodhur që ju jeni bindur, jeni njohur me kërkesat e palëve, jeni thelluar më shumë me ligjin dhe e keni ndryshuar qëndrimin tuaj. Unë mendoj që në këtë situatë ju keni ligjin, keni procesin, keni hallin se.. siç e thashë, vazhdoj e them pranë këtij komisioni që jeni në hallin që të ikën adoleshenti nga shtëpia dhe kështu po e mendoni të gjithë procesin. Në qoftë se ne themi logjikën, ju kur shikoni shqyrtimet në akt të cilët të tre aktet janë akte që i keni sjellë ju dhe ato me numra. Vetë e thatë në shqyrtim që nuk është saktë që të bie në kundërshtim me ligjin. Por, këtu kemi.. jemi ne partitë është polariteti i diskutimit, unë bëra një diskutim shumë të thjeshtë dhe ligjor edhe pa pathos. Këtë e bëra me idenë që duke kërkuar dhe duke sqaruar që në të mirë të procesit si të votimit edhe të numërimit është kjo lloj flete votimi. Në qoftë se nuk do të ishin këto numra emrash, 500 emra patjetër ne do të ishim që të bëhet me emra. Por, ne themi që bëhet i pamundur procesi i votimit në fletët e votimit me këtë lloj konfigurimi flete. Përpara se ne të mendojmë për zgjedhësit ne zgjedhësit duhet t’i japim një dokument sa më të thjeshtë për të votuar. Nuk mund t’u japim një gazetë për të lexuar, sepse votimi është një proces që zgjedhësit duhet ta kenë sa më të thjeshtë dhe sa më mirë të orientuar gjatë votimit pastaj parapëlqimin. Të

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

gjithë jemi të vetëdijshtëm që gara bëhet me numra nuk i bëjnë kandidatët. Megjithatë, kjo i mbetet vendimmarrjes suaj. Unë kam një kërkesë, para se ju të merrni vendimin tuaj duhet të rishqyrtoni edhe njëherë kërkesën. Unë kërkoj dhe këtë e kam në formë kërkesë që ju të shpreheni në lidhje me fletën e votimit me numra, ma pranoni kërkesën dhe nëse nuk pranoni të votoni shqyrtimin e aktit që ju keni, meqenëse kërkesat e subjekteve shqyrtohen para kërkesës që ju vendosni. Këto i jepen administratës, depozitohen në 12 qarqe, 12 fletë votimi me numër. Dua të shpreheni me vendim dhe arsyetim pse ju nuk më pranoni këtë model flete që ju vetë keni paraqitur.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Mundem?

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe njëherë zonja Bushati dhe do t'i japim fund diskutimit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Atëherë, Komisioneri ishte shumë i qartë në relatimin e aktit dhe në përcjelljen e aktit për njohje subjekteve politike. Në relatimin e aktit u saktësua që versioni i sjellë nga Komisioneri është versioni me emra. Tani po dëgjojmë që Komisioneri po shantazhohet për t'u shprehur mbi një version që sot nuk e kemi objekt shqyrtimi. Për çfarë duhet të shprehet Komisioneri? Mbi diçka që nuk është në rend të ditës, nuk është objekt shqyrtimi. Sjell në vëmendje dhe të Komisionerit që jemi në limitet kohore për realizimin e fletës së votimit. Nga informacionet që kam, shteti Slloven është në mbyllje totale nuk e di se si do bëjë ky komision në realizimin në kohë të fletës së votimit. Kjo do të thotë që vendimmarrja juaj duhet të jetë e tanishme dhe pa humbur asnjë kohë tjetër. T'i lemë shantazhet, t'i lemë diversionet, t'i lemë planet "b" që kanë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

subjekte të caktuara politike ndërkohë që këtu është shprehur vullneti i pjesës dërrmuese të subjekteve politike, të cilët e kanë lexuar drejtë dhe saktë Kodin Zgjedhor, frymën e ligjvënësit. Qytetarët janë të përgatitur të votojnë emrin, numrat janë thjesht për rend zbritës ose rritës për të identifikuar listën totale sipas qarqeve. Numrat nuk mund të votohen. Në këtë rast kemi fletën që përcakton dhe numrin dhe përbri tij emrin e kandidatit përkatës. Ju lutem, të merrni një vendimmarrje sa më të shpejtë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, nëse kemi ndonjë argument tjetër ligjor, zonja Bushati se nëse do të vazhdojmë me replika ndërmjet jush nuk do të përfundojë kurrë.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Jo për replikë, doja vetëm një shtesë që nuk e thashë tek fjala ime. Unë dua të vë theksin në një gjë, sepse dëgjova shumë dhe.. po themi gjatë fjalëve për këtë dashuri të madhe që të ketë emra dhe jo numra. Kodi Zgjedhor është.. ose sistemi ynë zgjedhor është mbi subjektin zgjedhor dhe nëse bëhet fjalë për kë është primar në listën e votimit është subjekti zgjedhor. Sigurisht që është shumë mirë që në fletën e votimit të jetë dhe subjekti dhe kandidatët me emra. Por, ajo që ne si subjekt zgjedhor pretendojmë është qartësia. Kur flasim për tek qartësia atëherë, kush duhet të jetë më e qartë subjekti apo emrat e kandidatëve brenda subjektit? Kaq i qartë ka qenë Kodi Zgjedhor, sa ai e quan votë për subjektin zgjedhor edhe nëse nuk votohet për asnjë nga kandidatët. Pra, ka shumë shanse që unë të shkoj të votoj dhe duhet të votoj partinë, nuk më intereson fare se cili kandidat ka cilin numër. Sepse, votimi parapëlqyer dhe unë këtu dua ta vë theksin, këtu nuk po votojmë për kandidatë ne po votojmë për parti. Votimi parapëlqyer është përbrenda kandidatëve të së njëjtës parti. Fleta e votimit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

është e vlefshme edhe kur nuk votohet asnjë kandidat. Madje, shkon votë për subjektin edhe kur votohen disa kandidatë brenda të njëjtit subjekt. Atëherë, përse duhet që zgjedhësi në Tiranë të ketë vështirësi ekstreme 400 herë më të vështirë për të gjetur një emër sesa zgjedhësi në Kukës? Kjo vetëm për mua meqenëse unë nuk do të doja të bëja propagandë këtu, por kjo pse në një parti ka problem se duhet t'i votohet kryetari i partisë. Sepse, njerëzit mund të mos e dinë se kush është kryetari i partisë dhe kanë nevojë të shohin emrin, ky nuk është problemi i zgjedhësit. Ne votojmë subjektet zgjedhore. I hapur, i pahapur parapëlqimi është brenda partisë që votohet nuk është kandidati primar. Nuk është sistem mazhoritar që na duhet emri i kandidatit. Nëse unë do të votoj Partinë Demokratike, unë do të votoj Sali Berishën nuk do të votoj 30-tën e listës. Kështu që, në këtë kuptim ne nuk kemi pse procesin ta fusim në shina dhe jo ligjore, sepse për mua një zgjedhës në Kukës është i barabartë me një 80 vjeçar në Tiranë. Një 70 vjeçar në Kukës është i barabartë me një 70 vjeçar në Tiranë, i cili kur të shohë fletën e votimit do e kapë ndonjë sëmundje, të shohë aty, të orientohet me 400 emra. Kështu që, në këtë kuptim unë ju kërkoj që ta konsideroni fletën e votimit në raport me çfarë është primare për sistemin zgjedhor. Vota e parapëlqyer brenda listës së kandidatëve është brenda subjektit. Nuk ikën vota gjëkund edhe nëse ti nuk e di që numri 1 i takon Lulzim Bashës në Tiranë dhe voton 4-ën që është i Sali Berishës prapë Partinë Demokratike ke votuar.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zonja Bushati. Dakord, sepse do të kalojmë në përsëritje të të gjithë argumenteve. Mendoj që nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër shtesë të atyre argumenteve që u parashtruan deri tani ta përfundojmë shqyrtimin, të bëjmë një pushim dhe të vazhdojmë. Pasi do të bëjmë një vlerësim të të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

mendimeve, propozimeve sepse pati disa propozime dhe mendime në lidhje me secilën prej varianteve. E lemë nga ora 14:00 mbledhjen?

Mirë, në orën 14:00, faleminderit.

Rifillon Seanca publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Ora 17:14

Z. I. Celibashi: Mirë atëhere, fillojmë seancën. Besoj se pretendime dhe parashtrime të tjera në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi. Fillimisht shprehem në lidhje me kërkesën e paraqitur nga Partia Socialiste. Në vlerësim të asaj çfarë u parashtrua nga ana ime si Komisioner dhe bazuar në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor, vendos:

Rrëzimin e kërkesës së Partisë Socialiste për shqyrtimin e versionit të fletës së votimit në përmbajtje të së cilës kandidatët janë të shënuar vetëm sipas numërit rendor në listën shumëemërore të paraqitur prej tyre si subjekt zgjedhor.

Atëherë, në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit, vendimi i Komisionerit është ky:

Miratimin e fletës së votimit me përmbajtje sipas lidhjeve respektive për çdo qark, në formatin landscape, duke përshtatur sipas numërit të kandidatëve, madhësinë e fontit dhe stilizimet e logove.

Për lehtësi të të kuptuarit ky do të jetë formati i fletëve të votimit (paraqet fletën e votimit që do të përdoret për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021). Kuptohet që për çdo qark mënyra e të shkruarit fonti dhe karakteristika të tjera teknike të shkrimit mund të varen nga numëri i kandidatëve për çdo qark. Tani, për të mos i demonstruar të gjitha, këtu kam Qarkun Fier, Qarkun Tiranë, Qarkun Vlorë dhe të gjitha qarqet me rradhë nuk po zgjatem. Atëherë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi, faleminderit!

Mbyllet kjo pikë e rendit të ditës, zoti Kaso, fjala për ju për një çështje që është jashtë rendit të ditës!

Z.I.Kaso, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner! Doja dhe një saktësim tek dispozitivi i këtij vendimi ose dhe tek pjesa arsyetuese, ku duhet të përmendet kërkesa jonë për sa i përket, sigurisht siç e miratuat ju me emra, por për sa i përket versionit portret. Të paktën të përmendet kjo çështje.

Z. I. Celibashi: Të dyja si versionit portret si ai që propozoi Partia Socialiste nuk janë konsideruar dhe ky do të jetë përfundimtari.

Z.I.Kaso, përfaqësues i PD-së: Thjesht të përmendet në vendimmarrje. Ndërkohë që problematika e dytë lidhet me një çështje jashtë rendit të ditës të cilën unë do ta përmendja. Kemi të bëjmë me raste flagrante dhe të përsëritura nga të gjithë kryetarët e bashkive, të cilët në bazë të ligjit dhe në bazë të udhëzimit që ju keni miratuar, në mos gaboj udhëzimi nr.6. Ata kanë për detyrim që të përcaktojnë 35 ditë para ditës së zgjedhjeve vendndodhjet për të gjitha subjektet, të materialeve propagandistike për mënyrën e shpërndarjes dhe të raportimit të tyre në çdo bashki që ata administrojnë. Sot jemi 25 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe jo vetëm kryetarët e bashkive nuk e kanë ushtruar këtë detyrim ligjor, pra janë 10 ditë në shkelje të detyrimit ligjor, por nga ana jonë u jemi drejtuar me shkresë zyrtare të gjitha bashkive të republikës për të përcaktuar vendndodhjen e vendeve ku subjektet politike do të bëjnë fushatë zgjedhore në bazë të parashikimeve të ligjit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

dhe në bazë të parashikimeve të Udhëzimit nr.6 të KQZ për këtë çështje. Jo vetëm që nuk kanë reaguar, por jemi përpara një shtate inercie totale, pra ku nuk denjojnë as t'u kthejnë përgjigje shkresave që u drejton subjekti më i madh i opozitës dhe jo më t'i caktojnë vendet për të bërë fushatë në të njëjtën mënyrë me Partinë Socialiste. Kujtoj këtu që të 60 bashkitë të cilat administrohen drejtë për së drejti nga të emëruar nga Partia Socialiste, kanë përcaktuar vendet në të gjitha qytetet dhe në të gjithë territorin administrativ që ata mbulojnë vetëm për një subjekt zgjedhor që është Partia Socialiste e Shqipërisë, në shkelje flagrante të ligjit. Siç e thashë dhe më parë kanë detyrimin ligjor të përcaktojnë vendet në mënyrë të barabartë dhe këtë ta bëjnë në një kohë sa më të shpejtë. Nuk e diskutoj këtu që duhet të kishin kthyer përgjigje. Nuk e diskutoj këtu që duhet të kishin vënë këtu sipas udhëzimit, në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për ato gjëra që ata kanë detyrim që t'i sigurojnë partive politike. Kërkoj nga ana e KQZ-së që të merren masa urgjente për zgjidhjen e kësaj shtate. Ne si subjekt zgjedhor, publikisht bëjmë me dije se jemi duke përgatitur 60 kallëzime penale për 60 kryetarët e bashkive që nuk e kanë ushtruar këtë detyrim ligjor, për t'i çuar që ditën e nesërme të gjithë përpara përgjegjësisë penale. Meqenëse KQZ ka tagra që i jep ligji që të ndërhyjë në këtë lloj vendimmarrje, le të themi jo vetëm t'u kërkojë llogari nga një anë, por edhe mund të marrë masa të tjera pro-aktive. Ftojme Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që në rradhë të parë të futet në komunikim të menjëhershëm dhe në rradhë të dytë t'i japë fund kësaj shtate abuzimi total. Jemi në kushte që nuk ka ndodhur ndonjëherë në ndonjë palë zgjedhje kur i gjithë pushteti vendor administrohet nga një forcë politike. Kjo forcë politike ka zënë çdo hapësirë publike, jo vetëm në territoret e bashkive dhe territoret urbane, por dhe në territore rurale, për më tepër në kundërshtim flagrant të ligjit ka zënë dhe gjithë pjesën në administrim shtetëror që gjendet buzë rrugëve nacionale dhe buzë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

autostradave. Kujtojmë që në bazë të Kodit Rrugor e në bazë të ligjit, këto sipërfaqe janë në administrim të drejtë për drejtë të ARSH, Autoritetit Rrugor Shtetëror i cili është i vetmi që ka kompetencën së bashku me subjektet private që administrojnë të ashtuquajturat vende për banerat. Janë këta që do të përcaktojnë nëse do të përdoren këto hapësira reklamuese apo jo. ARSH-ja është një institucion publik, është në varësi të një ministrie konkrete e të një ministreje që është garuese në këtë garë zgjedhore, siç është le të themi çdo kandidat që ligji e përcakton si subjekt zgjedhor. Kështu që dhe në këtë rast kemi të bëjmë me një abuzim flagrant të detyrës, kujtojmë raste, jo më larg se ditën e djeshme është evidentuar, e kemi material fotografik dhe le t'ia përcjellim dhe KQZ që gjithë rruga Korçë – Tiranë, pra gjithë ky aks nacional nuk ka hapësirë reklamuese e cila përdoret dhe për qëllime publike si ulje e shpejtësisë, ose evidentimi i vendeve të rrezikshme, që të mos jetë zënë me banera të Partisë Socialiste. Kështu që është një situatë e pa precedentë dhe e pa ndodhur ndonjëherë. E sjell zyrtarisht në vëmendje të KQZ, së bashku do t'u dërgoj dhe materialet filmike dhe fotografike që ne kemi paraqitur. Në qoftë se është e nevojshme, unë ju lexoj edhe datat e shkresave, në qoftë se duhen për rekord të shkresave që ne si subjekt politik u kemi dërguar kryetarëve të bashkive, në mënyrë që të ngelen të memorizuara dhe KQZ-ja të ketë mundësi që të verifikojë. Po lexoj vetëm disa, që në datën 29 mars është dërguar Bashkisë Memaliaj. Beratit në datën 30, Patosit 25, Tepelenës 29, Ura-Vajgurore 29, Poliçanit 25, Përmetit 29 që t'i caktojnë. Vlorës në datën 30, Selenicës datë 29, Fierit datë 29. Tiranës i është drejtuar nga disa degë të Partisë Demokratike në varësi të ish njësive administrative duke filluar që nga data 23 dhe duke përfunduar ditën e djeshme. Rrogozhinës në datë 29, Vorës në datën 30, Kamzës në datë 30, sepse jo vetëm që nuk e kishin caktuar por ende dhe sot që flasim nuk kanë kthyer përgjigje që do t'i përcaktojnë këto vende apo jo. Kështu që kemi të bëjmë me një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.04.2021*

shqetësim të madh dhe kërkojmë në mbledhjen e radhës që ju do të ndërmerrni të përcaktohet sa më shpejt hapësira në përputhje me ligjin, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po faleminderit zoti Kaso, mbajtëm shënim pretendimin tuaj në lidhje me lëndën përkatëse. Do t'i adresojmë këto shqetësime në mënyrë urgjente kryetarëve të bashkive, do të kërkojmë prej tyre informacion në lidhje me zbatueshmërinë e aktit të KQZ-së mbi vendosjen e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore. Po kështu do t'i kërkojmë informacion Autoritetit Rrugor Shqiptar në lidhje me vendosjen e billboard-erave anës rrugëve nacionale, faleminderit!

Kemi pikë tjetër në rendin e ditës për të shtuar?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kemi!

Z. I. Celibashi: Emërim, zëvendësim anëtarësh të KZAZ-ve?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk i kemi gati.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord, seanca mbyllet!

Vendimi nr.198

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

